

“ BETEJA PËR UJIN ” e piktorit Gazmend Leka
nga biseda në studion e artistit dt.30/12/2006



“... kjo (tablo) thellë – thellë është legjenda sekrete e Shqipërisë edhe për faktin se Shqipëria është një vend i mbjellur me ujë... është hymni i një shkretëtire shpirtërore e mbushur me klithma njerëzish që kanë etje, siç ndodh rëndom në Shqipëri, ku me një goditje të vetme, të zgjuar, inteligjente mund ta kthesh në një kopësht të lulëzuar... ”

Tabloja “ Beteja për ujin ” e piktorit Gazmend LEKA, i përket ciklit të tablove simboliko – filozofike, që artisti ka realizuar në vazhdimësi në krijimtarinë e tij, por që në artin laik shqiptar, si cikël, realizohet për herë të parë. Elementet e dukshëm të pikturuar në tonet e ngjyrave gri e që përbëjnë tablonë janë: një imazh (në qendër të tablosë) ndërmjet pemës dhe shkurre, që të jep idenë e një kaktusi në shkretëtirë. Në horizont në anën e djathtë të tablosë, është pikturuar një kalë i zi i vetmuar, ndërsa në një plan më të afërt, paraqitet një shpatë (e shkurtër) e vendosur mbi tokë, një strukturë shkëmbore nga buron një curril uji që bie mbi një basen të pikturuar në plan të parë. Si edhe në tablotë e tjera të artistit Leka, figura njerëzore mungon dhe nuk zë vend realisht në to, pavarësisht se tema dhe mesazhi i veprës e nënkupton atë. Përsëri artisti Leka frymëzohet nga e tashmja e jetës shqiptare (vështirësive të jetës dhe mbijetesës) dhe e kaluara e largët biblike, që lidhet me emrin e Moisiut.

Siç shprehet vetë piktori Gazmend Leka “...në Botë qarkullojnë mendime se beteja e ardhme e njerëzimit do të jetë për ujin dhe jo për naftën. Duket si lajthitje, meqenëse Bota është e mbuluar me ujë dhe naftë, por uji është i dukshëm, - dhe ky është mendimi që e gjen tek gjeopolitka. Për njeriun e zakonshëm, kjo është një gjë e pakuptueshme, gati – gati në kufijtë e lajthitjes. Ajo që më ka shtyrë të krijoj tablonë “ Beteja për ujin ”, është që legjenda moderne për ujin koïncidon me legjendën antike për ujin. Të gjitha qytetërimet kanë lindur buzë lumenjve, liqeneve dhe deteve (Egjipti, Babilonia, Roma etj)...”

Tabloja edhe pse në titull nënkupton një betejë, në telajo asnjë imazh nuk e pasqyron atë, përkundrazi aty ndofta duken “ gjurmët ” e saj si p.sh... “ Kali pa të zotin ”, “ Shpata pa luftëtarin ”, që simbolikisht aludojnë betejën e cila tashmë ka mbaruar. Në këtë vepër njëlloj si në veprat e tjera të këtij cikli, mbizotëron një qetësi, gati e frikshme për atë që ka ndodhur dhe më me mister është ajo që do të ndodhë. Ankthi dhe tensioni janë të dukshëm së pari, nga tonaliteti gri i veprës (shpesh grija shkon nga tonaliteti gri në të verdhë dhe herë – herë nga tonaliteti gri në violet). Së dyti, nga momenti i paraqitur në tablo që piktori gjithmonë e përzgjedh si një moment i sapo dalë nga parajsa dhe ndodhesh në purgator, ekziston një moment pritjeje i

asaj që do të ndodhë (nga personazhet e padukshëm në tablo), “ është qenia njerëzore, - shprehet piktori Leka, që ka etje dhe që më së fundi realizon objektin e vet – jetën ”.

Piktori në tablo ka përzgjedhur të komunikojë me elementet simbolikë të saj, që sigurisht nuk janë për një publik të gjerë e të pa informuar. Vepra duke qenë se përmban motive nga dy drejtime: aktualiteti shqiptar dhe bibla, bëhet akoma më hermetike dhe e koduar. Curili i ujit i pikturuar në anë të tablosë, në mënyrë të thjeshtë e që nuk tërheq vëmendjen është edhe “ çelësi ” i kësaj vepre simboliko – mistike. Pema (kaktus) në qendër të tablosë e kalçifikuar dhe e pa formë, krijon imazh jorealit në kufijt e një legjende, ku drita diellore është shuar dhe tablonë e ndriçon një dritë tjetër ajo shpirtërore – artistike, një dritë pa kontraste e ngjyrë, ku çdo objekt është në tonalitetet e grisë dhe imazhet janë herë të qarta e herë të mbështjella nga misteri ireal i artistit. Duhet të qëndrosh gjatë para veprës për të dalluar dhe komunikuar me detajet e çdo objekti të paraqitur, që janë realizuar me një profesionalizëm dhe teknikë në mënyrë të përkryer.

Ylli DRISHTI
Studiues arti në GKA, Tiranë.

Ky shkrim është botuar tek Revista ”MONITOR”.